

BASHKIA LEZHË

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. 6188 Datë 23/07/2018

**PËR**

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmes financiare për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës të shtetasit Gjovalin Zef Prendi, banor në fshatin Balldre i Ri, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhe.

Ne mbeshtetje te nenit 54 te ligjit 139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore" Ligji 8756, dt26.03.2001 "Për Emergjencat Civile", VKM Nr.329,dt.16.05.2012 "Për Kriteret dhe Procedurat e dhenies së ndihmes shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore" Këshilli i Bashkisë Lezhë, pasi u njoh me relacionin e pergatitur nga Sektori i Emergjencave Civile dhe Menaxhimit të Krizave, mbi demin e shkaktuar në banesen e Z.Gjovalin Zef Prendi, banor në Balldre i Ri, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhe, pas diskutimit te anetareve,

**Vendosi:**

1.Të miratoje kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbeshtetje financiare të shtetasit Z.Gjovalin Zef Prendi për dëmtimin e banesës se tij nga zjarri.

**A.Te miratoje demin e shkaktuar nga zjarri në vleren 452232 lekë.**

**a)Demi i shkaktuar në ndertese 354732 lekë.**

**b)Demi i shkaktuar në orendi,mobilje e pajisje 97500 lekë.**

B. Mbeshtetur ne VKM. Nr 329 dt.16.05.2012,kap3,pika 3, germa b e ç Kompensimi per demin e shkaktuar ne anen ndertimore te jete ne masen 50%, ndersa Kompensimi per demin e shkaktuar ne orendi, mobilje e pajisje, mbeshtetur ne kap 3,pika 3 germa d te VKM si mesiperme te jete sa masa e demit te shkaktuar dhe konkretisht :

**a)Vlera e Kompensimit te demit ne anen ndertimore te jete 177366 lekë.**

**b)Vlera e Kompensimit te demit ne orendi, mobilje e pajisje 97500 lekë.**

**Vlera totale**

**274866 lekë.**

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.

3. Bashkia Lezhe ti akordojë familjes së shtetasit Z.Gjovalin Zef Prendi ndihmen emergjente në vlerën prej 137433 lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkise për vitin 2017, bazuar në VKM nr.329 dt.16.05.2012

4. Bashkia Lezhe ti paraqesë dokumentacionin perkates dhe ti kerkojë mbeshtetje Ministrise së Puneve të Brendshme (DPEC) nepermjet Prefektit Qarkut Lezhe, për akordimin e pjesës së mbetur prej 137433 lekë, për shkak të pamundësisë së Bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.

5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për të ardhur në ndihme familjes së shtetasit Z.Gjovalin Zef Prendi, banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri.

**KRYETARI**

**Fran FRROKAJ**

